



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

7847
DE 21.11.2025

Librazhd më: 23.11.2025

NJOFTIM

“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”

Z.znj. _____

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Mërkurë, datë 26.11.2025**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Nëntor** 2025. Mbledhja do të zhvillohet te Salla e Këshillit në Bashki me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.10.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha tetor 2025”.
4. **P/Vendim** “ Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”.
5. **P/Vendim** “ Për rritje e pakësim plani buxhetor të vitit 2025 të të ardhurave vendore”.
6. **P/Vendim** “ Për linjat kryesore dhe oraret e transportit rrethqytetas”
7. **P/Vendim** “ Për miratimin e ndërhyrjeve në pronë publike për efekt të mbrojtjes së pronave private”.
 - Prezantimi dhe Diskutimi i Raportit të Performancës të Bashkisë Librazhd , viti 2024.
8. **Të ndryshme:**
 - *Ditën e martë datë 25.11.2025 ora 10:00 të mbledhen Komisionet te Salla e Këshillit Bashkiak.*

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BICAKU



PROCEVERBAL I MBLEDHJES 28.10.2025

- I mbajtur sot më datë 28.10.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
- Pasi u lexua rendi I ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 14vota pro.
Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Flutur Kojku,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Illir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Erjola Albrahimi,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi(Këshilltarët e pranishëm).
- Miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 30.09.2025 me të gjitha votat e të pranishmëve 14 vota pro.

Këshilltarja Fatbardha Qatja e merr fjalën:

Shikoj procesverbalin që fjalët nuk janë shkrujt 100% siç I kam thënë por me shkurtime,kërkoj që në mbledhjet e tjera procesverbali të shkruhet I plotë dhe i saktë.

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Flutur Kojku,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Illir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Erjola Albrahimi,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi(**Këshilltarët e pranishëm**).

- **Miratohet fillimi I mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:**

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.09.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha shtator 2025”.
4. **P/Vendim** “ Për miratim shtesë punonjësish në Stacionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”.
5. **P/Vendim** “ Shtesë fondi për klubin e futbollit Sopot”
6. **P/Vendim** “ Për dhënie ndihme financiare”.
7. **P/Vendim** “Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë Librazhd nëpërmjet marrveshjes për pronat në pronësi të saj”.
8. **P/Vendim** “Mbi propozimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve në pronësi të Bashkisë dhe Njësive varësi të saj”.
9. **P/Vendim** “Për dhënie ndihme financiare”.
10. **Të ndryshme:**
 1. **P/Vendim** “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e strehimit”
 2. **P/Vendim** “ Shtesë granti sipas aktit normative Nr.10 datë 08.10.2025”
 3. **P/vendim** “ Përdorim fondi reserve”

Fillimi I mbledhjes:

1.P/Vendimi “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha shtator 2025”.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Unë jam e mendimit që në mbledhjet e këshillit bashkiak të marrin pjesë dhe Administratorët e Njërive përkatëse pasi ata njihen me mire me situatën në terren dhe vështirësitë që ka çdo familje.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 14 vota pro.

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Flutur Kojku,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Illir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Erjola Albrahimi,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi(**Këshilltarët e pranishëm**).

2.“P/Vendim “ Për miratim shtesë punonjësish në Stacionin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Mua realisht më vjen shumë mire që e kemi marrë këtë fond,duhet falenderuar Kryetari I Bashkisë .Pse ishte emergjente që ky fond të shtohet pikërisht të zjarrëfiksja?

Këshilltari Bledi Koçi e merr fjalën.

Ne e kemi miratuar dhe në parim ne shkurt të vitit 2024 për një shtim numri të punonjësve të zjarrfikses.Dhe në lidhje me zjarrfiksen e re që ka ardhur ku Kryetari i Bashkisë ka thënë që është financuar nga Ambasada Japoneze por dhe ne kemi pas pjesë në financimin e zjarrfikses.Kjo zjarrefikse besoj që do jetë vetëm për pjesën e qytetit sepse ne fshatra që nuk ka asfalt nuk besoj se futet.Unë ngrita si shqetësim dhe ne mbledhjen e muajit shtator që të përfshiheshin dhe zonat e mbrojtura në këtë shpërblim pasi dhe ata kanë qënë në monitorim të vazhdueshëm dhe grup pune me zjarrëfiksit,duhet rishikuar dhe për ata.

Sekretari I Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në rradhë të pare duhet falenderuar Këshilli Bashkiak që na e miratoj në parim rritjen me 6 punonjës në repartin e zjarrfikses.Ne i bëmë një shkresë Ministrisë së Financave për një shtesë fondi si për shpërblimin e një page por dhe për shtim të numrit të punonjësve.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 15 vota pro.

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Flutur Kojku,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Illir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Erjola Albrahimi,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi,Arben Hoxha (**Këshilltarët e pranishëm**).

3.P/Vendim“ Shtesë fondi për klubin e futbollit Sopotit”

Këshilltarja ,Arjana Çekrezi e merr fjalën;

Në fakt nuk ka gjë më të mirë që po jepni shtesë fondi për ekipin e Sopotit.Kam një shqetësim në lidhje me nxënësit që e bejnë shkollën mbasdit dhe ngelin pa bërë stervitje me ekipet e tyre të moshave.Dhe kur kanë ndeshje ekipet e moshave transportin e paguajn vetë.A ka ndonjë mundësi që ti financoj klubi këto ekipe.

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Ju keni kërkuar shtesë fondi për trajnerët dhe lojtarët dhe shikoj tabelën bashkilidhur p/vendimit që shkruan 0 lekë,mos keni bërë ndonjë gabim.A ka ndonjë sponsor që ta ndihmoj ekipin apo mbahet vetëm nga fondi I bashkisë,mbaj mend nga viti 2015-2016 që ka pas tentativa për ta privatizuar.

Këshilltari, Kujtim Albrahimi e merr fjalën.

Ne jemi një qytet I vogël dhe sytë i kemi vetëm tek ekipi i Sopotit.A ka pas ndonjë tentative nga ana e Bashkisë për të gjetur një sponsor që të ndihmoj ekipin?

Sekretari I Përgjithshëm,Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Bashkia është e gatshme ta privatizoj në qoftë se do dali mundësia.Me kaq mundësi që ka Bashkia ne kemi bërë të mundur të kemi terrene sportive,kemi vënë në dispozicion dhe një autobus ku bën të mundur transportin e ekipit të parë por dhe ekipet e moshave.Ne patëm një kursim fondi dhe pamë të mundur shtesën e fondit prej 20 milion lekesh të vjetra lidhur dhe me kërkesën e Administratorit të klubit Sopot.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 16 vota pro.

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Flutur Kojku,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Illir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Erjola Albrahimi,Arjana Çekrezi,Kujtim Albrahimi,Arben Hoxha,Habil Biçaku **(Këshilltarët e pranishëm).**

4.P/Vendim “ Për dhënie ndihme financiare”.

Këshilltari, Zenel Bahiti e merr fjalën.

Në rradhë të parë shume faleminderit Bashkisë Librazhd dhe Këshillit Bashkiak! Unë në bazë të ligjit tërhiqem nga ky p/vendim pasi kam konflikt interesi, ku kërkesa për ndihmë financiare është e vëllait tim.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Erjola Albrahimi, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (**Këshilltarët e pranishëm**).

5. P/Vendim “Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë Librazhd nëpërmjet marrveshjes për pronat në pronësi të saj”.

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Bashkia Librazhd mund të jetë ndër bashkitë e fundit që miraton këtë lloj procedure. Kjo ka të bëjë me një qytetar që ka sjellë një projekt dhe një marrveshje paraprake. Është një rrugë e gjatë që do të ndjekë. Por fillimi i procedurës fillon nga ky p/vendim ku duhet miratuar ky si fillim që të hapet rruga për procedurat e mëtejshme. Bashkia Librazhd në rast se është truell fiton 25% të sipërfaqes dhe në qoftë se është ndërtesë dhe prishet bashkia fiton 50% të sipërfaqes. Të gjitha insitucionet e bashkisë e vuajn këtë pjesen e magazinave dhe do të jetë një gje shumë e mirë për bashkinë tone.

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Çfarë pronash ka bashkia Librazhd që mund të verë në dispozicion të investitorëve? A ka bashkia një listë që çfarë pronash ka? Ju thonë nëse është godinë, bashkia fiton 50% të sipërfaqes? Kshu I bie që investitori të bëhet ortak me bashkinë atëher çfarë fitimi do të ketë ai që të jetë ortak me bashkinë? Mendoj se është një tarif shumë e lartë për investitorët. Jemi para një fakti që po ikin të gjithë nga Librazhd.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Sa siguri kam unë si investitor që të vi dhe të investoj? Apo fatet janë të përcaktuara?

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Deri më sot bashkia nuk ka pranuar kërkesa të tilla pa bërë të mundur miratimin e këtij p/vendimi.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Erjola Albrahimi, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (**Këshilltarët e pranishëm**).

6.P/Vendim “Mbi propozimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve në pronësi të Bashkisë dhe Njësive varësi të saj”.

Këshilltari, Zenel Bahiti e merr fjalën.

Unë jam pjesë e komisionit të Ekonomisë dhe shikoj një vlerë shumë të lartë dhe ka akoma shumë material për ti nxjerrë jashtë përdorimit.

Këshilltari, Ndriçim Doda e merr fjalën.

Këto materiale që keni verifikuar janë për shkak të amartozimit apo për shkaqe të tjera? Ka dhe plot material të tjera për të nxjerrë jashtë përdorimit, të mbahet një procesverbal përkatës për çdo material që nxirni jashtë përdorimit në qoftë se janë dëmtuar me dashje të paguhet nga vetë dëmtuesi.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Meqë kemi një shumë vërtetë të lartë ta shikonit dhe njëher më me terezi, e mira do ishte të na vihej në dispozicion kjo shumë dhe njëher mbas mbledhjes, që çfarë është dëmtuar, çfarë është agjensuar dhe çfarë keni arkëtuar?

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Shikoj disa terma shumë të çuditshëm psh pantallonat e policies bashkiake ju I merrni me të njëjten vlerë si në vitin 2019 dhe tani që jemi në 2025. Vlera totale është shumë e madhe por komisioni duhet të vinte dhe vitin që I kanë marrë në dorzim.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Erjola Albrahimi, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (**Këshilltarët e pranishëm**).

(Ky p/vendim dhe pas miratimit të këshilltarëve nuk është zbardhur në vendim pasi vlera totale ishte gabim dhe ta fusim për saktësim në muajin në vazhdim.)

7.P/Vendim “Për dhënie ndihme financiare”.

Këshilltarja, Fatbardha Qatja e merr fjalën;

Mesa di unë personi në fjalë është në mardhënie pune se po lexoja kërkesë ku shprehej jemi dy motra pa punë, të paktën të thotë faleminderit për punën.

Albana Hoxha e merr fjalën:

Mbase është shprehur gabim dhe e ka pas për të motrën që e ka pa punë.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **16 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Erjola Albrahimi, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Arben Hoxha, Habil Biçaku (**Këshilltarët e pranishëm**).

- **Të ndryshme:**

1.P/Vendim “ Shtesë granti sipas aktit normative Nr.10 datë 08.10.2025”

Këshilltari, Bledi Koçi e merr fjalën.

Akoma paska fatura pa paguar shkolla e Dorzit? Po në lidhje me rrugën e Librazhd Katundit çfarë po bëhet? Pasi si rrugë është miratuar deri ne Librazhd Katund ku ajo aktualisht ka shkuar deri ne Librazhd Qendër dhe nuk shikojmë asnjë puntor që të punohet në lidhje me rrugën. Çfarë po bënë bashkia ne lidhje me rrugën? Ka ngelur për mungesë fondesh apo ka ngelur për ndonjë arsye tjetër.

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Momentalisht është financuar vetëm faza e pare. Rruga është marrë në dorzim në mënyrë të përkohshme, shtesa e grantit që na ka ardhur do e perdorim për likjudim faturash.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **15 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Erjola Albrahimi, Arjana Çekrezi, Kujtim Albrahimi, Arben Hoxha (**Këshilltarët e pranishëm**).

2.P/Vendim “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e strehimit”

Sekretari I Përgjithshëm, Bajram Pishkashi e merr fjalën.

Në lidhje me këtë p/vendim ne fusim për miratim sistemin e pikëzimit ,ku si fillim miratohen kriteret dhe në vazhdim miratojmë bonusin e qerasë. Dhe si gjithmonë listë do ta lëmë të hapur.

Këshilltarja ,Arjana Çekrezi e merr fjalën;

Dakort që lista do jetë e hapur por duhet shikuar me shumë vëmendje nga specialistët e zyrës përkatëse.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

Mitat Biçaku, Dashnor Hysa, Zenel Bahiti, Elidjona Bahiti, Fatbardha Qatja, Flutur Kojku, Bledi Koçi, Fiqirete Alliu, Ilir Kuka, Adelina Alla, Ndriçim Doda, Erjola Albrahimi, Arjana Çekrezi, Arben Hoxha (**Këshilltarët e pranishëm**).

3.P/vendim “ Përdorim fondi reserve”

Nuk ka pyetje nga këshilltarët

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **14 vota pro.**

Mitat Biçaku,Dashnor Hysa,Zenel Bahiti,Elidjona Bahiti,Fatbardha Qatja,Flutur Kojku,Bledi Koçi ,Fiqirete Alliu,Ilir Kuka,Adelina Alla,Ndriçim Doda,Erjola Albrahimi,Arjana Çekrezi ,Arben Hoxha (**Këshilltarët e pranishëm**).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT

Mitat BIÇAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

PROJEKT-VENDIM

Nr.23 Datë 17.11.2025

**“Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtezuar 6%”
(Periudha: TETOR 2025)**

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”

Nisur sa më lart nga verifikimi i sistemit elektronik i Ndhmës Ekonomike rezultojnë se janë refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) 76 Familje, dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6%: Gjithsej 76 Familje me një fond: **311,586** lekë. Vlera e ndihmës **248,474** lekë, vlera e energjisë **63,112** lekë

2-Të mos përfitojnë për arsye të mos plotësimit të kriterëve nga fondi i kushtëzuar 6% nuk ka familje.

3-Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.

4-Ngarkohen për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi Administratorët Shoqërorë të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative.

5- Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së Vendimit

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka

**KRYETARI I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

RELACION

Nr.23 datë 17.11.2025

**“Mbi Dhënien e Ndhmës Ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar 6%”
(Periudha: TETOR 2025)**

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” përcaktohet qarte se kush mund ta perfitoje kete ndihme nga fondi i kushtezuar 6% i bllok ndihmës ekonomike.

E rëndësishme është që familjet që nuk klasifikohen si përfituse në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike me pikë të pa mjaftushme të verifikohen saktësisht nga Administratori Shoqërore i Ndhmës Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike,sociale,shoqërore dhe duke pasur parasysh kriteret që janë miratuar në Këshillin Bashkiak ta vlersojë familjen nëse duhet apo jo që të klasifikohet si familje që duhet të përfitoje ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik ne familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 76 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 76 familje.

2- Te mos perfitojne nuk ka familje.

Njesitë Administrative:

1. Njësia Administrative Qytet	31 Familje me fond	126,122 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	9 Familje me fond	43,271 lekë
3. Njësia Administrative Polis	9 Familje me fond	33,505 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	17 Familje me fond	67,978 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	10 Familje me fond	40,710 lekë

Totali si Bashki 76 familje me fond 311,586 lekë.

Relacion për Familjet e Refuzuara

- Familjet që nuk janë rekomanduar për tu trajtuar nga fondi 6 % nuk ka.

Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike

Rexhep Shaka



FONDI 6%

Periudha: TETOR 2025

Bashkia Librazhd

Nr	Emri i Aplikantit	NID	Statusi aplikimit	Vlera e përlogaritur për fondin 6%	Kompensimi i Energjisë	Totali	Numri anëtarëve
1	Kujtim Ymerli Polisi	H00409064A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
2	Rabie Sadik Leka	G95628010G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
3	Muhamet Qazim Gega	G50501112O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
4	Avni Beqir Bogdani	H00106009U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3
5	Xhemile Xhelo Alliu	G75616178K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
6	Vera Mehmet Dada	I75404018N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
7	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
8	Eduart Xhevit Pali	I10524158W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,792	1,288	6,080	4
9	Ymer Xhaferr Kala	G31020023L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049	1,288	4,337	3
9	Total Njësia Administrative: Hotolisht			31,679	11,592	43,271	20
1	Shyqyrije Qazim Shpata	D66211004W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	2
2	Artur Musa Agastra	G10101021O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
3	Shyqyrie Belul Blloshmi	G65107079J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
4	Tahire Qamil Balla	G35812017F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
5	Vule Kadri Topi	F75710021A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
6	Farije Sefedin Topi	G05328025M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
7	Qamil Selman Ferra	F80501032B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
8	Olsi Nazmi Dosku	H50108018L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
9	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
10	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
11	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2

12	Leonard Enver Brasha	J60806018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
13	Piro Ferit Halili	H70320023A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
14	Arjan Mevlut Meta	I20327028C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
15	Nasibe Ismail Hunçi	G45229211O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
16	Artur Isuf Guga	G80721009F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
17	Lulzim Dylber Kazazi	G30612046C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
18	Alma Nexhat Kola	G45703011C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
19	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
20	Bule Myhedin Kojku	H55125015N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7,920	1,288	9,208	3
21	Mirjana Abdulla Çollaku	G76014110Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
22	Fatmira Beqir Hysa	H70522017S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
23	Qanije Refat Brasha	F95520031H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
24	Xhevahire Haziz Biçaku	G45120093D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
25	Sabije Livan Zyka	F66018008Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,720	1,288	7,008	1
26	Ramazan Tahir Brahja	G10225030V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
27	Ardi Osman Elezi	I61115008U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
28	Bujar Bajram Bahidi	G80316015M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
29	Albert Refat Brahja	I60413014P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,267		3,267	2
30	Deje Muharem Coha	G45915009K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
31	Lulzime Nebi Roçi	J55223019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	3
31	Total Njësia Administrative: Librazhd			102,938	23,184	126,122	47
1	Dashurije Islam Kiçi	F85303158B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
2	Astrit Xhevit Murtini	H00401317G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
3	Ismet Shaip Balliu	F61209003T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	6,752	1,288	8,040	4
4	Nazif Mehmet Qostja	F90730127I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
5	Bashkim Reshit Biba	G70701144N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
6	Nazmi Liman Ruçi	E60228033R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525		1,525	3
7	Kadife Abaz Balliu	G15710021S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
8	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,158	1,288	5,446	3
9	Zanushe Shefqet Haskurti	G76003005L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
10	Nadire Maksut Luka	E85901096E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1

10	Total Njësia Administrative: Orenje			32,982	7,728	40,710	21
1	Sadik Riza Zaimi	G30325115M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Afërdita Rexhep Tanushi	G46125056D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
3	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,752		4,752	2
4	Xhevahire Islam Zaimi	G95321059Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
5	Sabrie Sadik Shata	G95605100F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
6	Mexhit Nuredin Stërmugu	F90224131N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
7	Hava Hamit Hasani	G65823039B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
8	Nadire Mustafa Kasa	H26223016N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	3
9	Xhevrije Shahin Xhakeri	G65325034C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
9	Total Njësia Administrative: Polis			27,065	6,440	33,505	14
1	Suela Federit Shkurti	I65602016S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Ramadan Dalip Allushi	E20103061F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
3	Fatmir Kadri Hoxha	G40320186W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
4	Serme Kamer Qoshku	G65702019R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
5	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
6	Sanije Shefqet Alija	G65125222I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
7	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
8	Ymer Tafil Alla	G10625082P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
9	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
10	Trandafille Sulejman Çela	H05505324G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
11	Suzana Ramazan Almina	J45904016K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
12	Xhane Osman Kojku	G65105008W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
13	Sanie Qamil Hoxha	G15614006P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
14	Gani Bajram Faqolli	G40720092D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
15	Sabire Xhemal Shuli	A55716002R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
16	Fiqirete Ymer Ruplli	H85916021Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
17	Flamur Osman Dosku	G30729006Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
17	Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZHD			53,810	14,168	67,978	24
76	Totali Bashkisë			248,474	63,112	311,586	126

P/Vendim
nr. 2



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË
LIBRAZHD

P/VENDIM

Nr. _____, datë _____/_____/2025

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ,Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”,VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”,VKM nr. 1374, datë 10.10.2008,të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë Librazhd të mbledhur sot më datë ____/____/2025 pasi dëgjoi relacionin e përfaqësuesve të bashkisë :

VENDOSI :

1. Të miratojë me shkrim për dhënie në përdorim të sipërfaqes 2 ha në ngastrën 98b në ekonominë pyjore Çermenikë për ushtrimin e veprimtarisë “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure,gjeologjike e minerare,uji,vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe” .
2. Procedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Sekretari i Përgjithshëm, Sektori Juridik, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit të Bashkisë Librazhd, Drejtoria e Urbanistikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KONCEPTOI:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit
Përgjegjësi Menaxhimit
Aleksandër Brazhda

DREJTORI
Hysni Hoxha

KRYETARI I BASHKISË
Mariglen Disha

RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ,Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”. VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008,të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”.

Referuar kërkesave në adresë të bashkisë Librazhd për marrjen në përdorim të sipërfaqes 2 ha në ngastrën 98b të ekonomisë pyjore Çermenikë për ushtrimin e aktivitetit sipas VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1 pika 9 *“Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure,gjeologjike e minerare,uji,vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”*. **Sipërfaqja që do të merret në përdorim nga ky subjekt do të jetë objekt për të kryer zbulime gjeologjike e minerare nëpërmjet marrjes së kampioneve në këtë sipërfaqe.**

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,Bujqësisë dhe Turizmit (Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave) bazuar në urdhërin e kryetarit ka kryer studimin e ngastrës dhe rezultan që nga kontrata që do të nënshkruhet ndërmjet palëve,subjekti do të arkëtojë për llogari të bashkisë vlerën të përcaktuar sipas VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca 1 pika 9 *“Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure,gjeologjike e minerare,uji,vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”* :

**Afati i kontratës 1 – 5 vjet 192 000 (Njëqintenëntëdhjetëedymijë) lekë/vit.
 6 - 10 vjet 156 000 (Njëqintepesëdhjetëegjashëmijë) lekë/vit.**

(Subjekti në kërkesën e tij nuk e ka përcaktuar afatin e kontratës dhe në rast të miratimit do të përcaktohet në kontratë afati si dhe nuk do të jetë më shumë se 10- vjet)

Theksojmë se veprimtaria e parashikuar në këto sipërfaqe do të jetë vetëm për marrjen e kampioneve për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit gjeologjike e minerale dhe nuk do e dëmtojë ekosistemin e zonës ku do të merren këto kampione. Në rast se kerkuesit,arrin rezultat në kërkimin e tij në këtë sipërfaqe të marrë në përdorim me kontratë qiraje atëher për të ushtruar aktivitetin duhet që t'i nënshtrohet procedurave sipas VKM Nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre” kreu III. “Dokumentacioni i nevojshëm ndryshimin e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, për rastin e ndryshimit të kategorisë së përdorimit” në të cilën shpjegohet qartë mënyra për ushtrimin e veprimtarive në fondin pyjor/kullosor publik.

Nisur nga arsyet e mësipërme ne propozojmë që të miratohet dhënia e dakortësisë për kryerjen e këtij operacion kërkim zbulimi në këtë sipërfaqe me qëllimin që do të ketë një ndikim pozitiv në të ardhmen për zhvillimin e kësaj veprimtarie në Bashkinë Librazhd por dhe në gjenerimin e të ardhurave për komunitetin rrethues dhe buxhetin e bashkisë, rritjen e vlerave ekonomike në zone dhe krijimin e vendeve të reja pune.


Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak miratimin e ngastrës për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të fondit pyjor të Bashkisë Librazhd në mënyrë që Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit (Sektori i menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave) të vazhdojë procedurat e mëtejshme.

Bashkëngjitur këtij projekt vendimi po ju paraqesim:

- a. Fragment harte të objektit që kërkojmë të marrim me qira.

Jemi në pritje të miratimit nga ana J'uaj.

Përgjegjësi i Menaxhimit
Aleksandër Brazhda



DREJTORI
Hysni Hoxha

Hoxha 2025



Plenarim
Nr 3



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

P - VENDIM

Nr ____ Datë ____ / ____ / 2025

“PËR

RRITJE E PAKËSIM PLANI BUXHETOR TË VITIT 2025 TË TË ARDHURAVE VENDORE”

Në zbatim ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, 9632 date 30.10.2006 « Për Sitemin e Taksave Vendore » i ndryshuar , Ligji Nr 9920 , date 19.05.2008 » Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë « i ndryshuar, Ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” . Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 100, datë 27.11.2024 “ Paketa Fiskale 2025 , VKB per Planifikimin e Buxhetit për periudhën 2025, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.108, datë 27.12.2024 “ Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025” me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____ / ____ .2025 .

VENDOSI:

- 1-Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave të Bashkisë Librazhd .
- 2- Të miratojë pakësimin e planit të të ardhurave të Bashkisë Librazhd .
- 3- Rritja e planit në vlerën 8,783,000 lekë (bashkëlidhur tabela)
- 4- Pakësimin e planit në vlerën 14,900,000 lekë (bashkëlidhur tabela)
- 5 Ndjek zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar.
- 6- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha

P

Tabela Nr.2

BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TAKSAVE VENDORE

Datë më ,18.11.2025

PLANIFIKIMI I TE ARDHURAVE PER VITIN 2025 I NDRYSHUAR

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore

Në /Lekë

Nr	Lloji i taksës e tarifës	Planifikimi Viti 2025 Ishte	Planifikimi Viti 2025 Bëhet	Shtesa dhe pakësime
	Të ardhura tatimore			
	Të ardhura nga taksat vendore			
1	Tatim i thjeshtuar mbi biznesin e vogël	350,000	350,000	
2	Taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale	12,000,000	15,000,000	3,000,000
3	Taksa mbi ndërtesat	14,500,000	14,500,000	
4	Taksë mbi truallin	650,000	650,000	
5	Taksë tokë bujqësore	5,559,000	5,559,000	
6	Taksa e kalim të drejtës së pronësisë	250,000	250,000	
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndërtimet e reja	20,000,000	20,000,000	
8	Taksa e ndikimit në infrastrukturë legalizimet	15,000,000	15,000,000	
9	Taksë table	500,000	500,000	
10	Takse hoteli	350,000	350,000	
11	Taksa e regjistrimit përvitshëm të automjeteve	15,000,000	17,700,000	2,700,000
12	Taksë nga Renta	150,000	150,000	
		84,309,000	90,009,000	
	Te ardhura jo tatimore			
	Te ardhura nga tarifat vendore			
1	Tarife pastrimi	23,000,000	23,000,000	
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	3,700,000	3,700,000	
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	190,000	190,000	
4	Tarifa e sherbimit veterinar	300,000	300,000	
5	Tarife e tregut te organizuar	1,300,000	1,300,000	
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	39,000	39,000	
7	Tarife parkimi	1,353,000	1,353,000	
8	Tarife per dhenie license e certificate transporti	310,000	310,000	
9	Tarife per leje te drejta , vertetime,informacione	200,000	200,000	
10	Tarife per zenien e hapsires publike	2,260,000	2,260,000	
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	100,000	100,000	
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet.	3,000,000	3,000,000	
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	3,000,000	3,000,000	
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	430,000	430,000	
15	Tarife per mbetjet inerte	15,000	15,000	
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis	7,283,000	7,283,000	

	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e			
17	Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	120,000	120,000	
18	Kamatvonesa	1,000,000	1,000,000	
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	19,600,000	19,600,000	
	Shuma	67,200,000	67,200,000	
	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave			
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	28,000,000	22,000,000	(6,000,000)
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	800,000	800,000	
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	18,900,000	10,000,000	(8,900,000)
4	Nga shfrytezimi I druve te zjarrit nga fshataresia	5,000,000	5,000,000	
5	Nga shfrytezimi I prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	300,000	300,000	
6	Te ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	500,000	500,000	
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	200,000	200,000	
	Shuma	53,700,000	38,800,000	
	Te ardhura te tjera			
1	Qera e shitje trualli	-	-	
2	Qera ndertese , qera ndertese nga privatizimet	472,000	472,000	
3	Pagesa e prinderve çerdhe	2,400,000	2,400,000	
4	Pagesa e prinderve kopesht	9,200,000	9,200,000	
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet cerdhe dhe qendra ditore	1,424,000	1,424,000	
6	Gjoha nga IMT ,dhe Policia Bashkiake	1,650,000	1,650,000	
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	30,000	30,000	
8	Sponsorizime	-	3,083,000	3,083,000
	Shuma	15,176,000	18,259,000	
	TOTALI	220,385,000	214,268,000	(6,117,000)

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

RELACION
MBI SHITESË / PAKËSIM PLANI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË
PËR VITIN 2025

Të nderuar Këshilltarë :

Ne zbatim te Ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.108, datë 27.12.2024 " Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025" paraqesim për ndryshim të planit buxhetor pasi eshte e domosdoshme si shtese te planit në zerin sponsorizime,taksa nga tatami mbi të ardhurat personale,shtesë plani në zërin takse e rregjistrimit të përvitshëm të automjeteve dhe pakësim të planit në zerin tarifë në sektorin e pyjeve dhe tarife e shfrytëzimit të materialit drusor nga subjektet.

Për vitin 2025 të ardhurat janë planifikuar në vlerën 220,385 mije leke , dhe me këtë projekt - vendim po paraqesim shtesë /pakësim plani sipas zërave në tabelen e mëposhtme.

Nr	Lloji i taksës e tarifës	Planifikimi Viti 2025 Ishte	Planifikimi Viti 2025 Bëhet	Shtesa dhe pakësime
	<i>Të ardhura tatimore</i>			
	<i>Të ardhura nga taksat vendore</i>			
1	Tatim i thjeshtuar mbi biznesin e vogël	350,000	350,000	
2	Taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale	12,000,000	15,000,000	3,000,000
3	Taksa mbi ndërtesat	14,500,000	14,500,000	
4	Taksë mbi truallin	650,000	650,000	
5	Taksë tokë bujqësore	5,559,000	5,559,000	
6	Taksa e kalim të drejtës së pronësisë	250,000	250,000	
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndërtimet e reja	20,000,000	20,000,000	

Adresa : Sheshi "Gjorg Golemi"Librazhd, www.bashkialibrazhd.gov.al info@bashkialibrazhd.gov.al

8	Taksa e ndikimit në infrastrukturë legalizimet	15,000,000	15,000,000	
9	Taksë table	500,000	500,000	
10	Takse hoteli	350,000	350,000	
11	Taksa e regjistrimit përvitshëm të automjeteve	15,000,000	17,700,000	2,700,000
12	Taksë nga Renta	150,000	150,000	
		84,309,000	90,009,000	
	Te ardhura jo tatimore			
	Te ardhura nga tarifat vendore			
1	Tarife pastrimi	23,000,000	23,000,000	
2	Tarife ndricimi+Gjelbrimi	3,700,000	3,700,000	
3	Tarife sherbimi ne varrezat publike	190,000	190,000	
4	Tarifa e sherbimit veterinar	300,000	300,000	
5	Tarife e tregut te organizuar	1,300,000	1,300,000	
6	Tarifa leje per tregetim ambulator	39,000	39,000	
7	Tarife parkimi	1,353,000	1,353,000	
8	Tarife per dhenie license e certificate transporti	310,000	310,000	
9	Tarife per leje te drejta , vertetime,informacione	200,000	200,000	
10	Tarife per zenien e hapsires publike	2,260,000	2,260,000	
11	Tarife per librat e udhetimi te udhetareve brenda vendit	100,000	100,000	
12	Tarifa per autorizime ushtrim aktiviteti, autorizime per karburantet.	3,000,000	3,000,000	
13	Tarifa te tjera nga Urbanistika	3,000,000	3,000,000	
14	Tarife per linjat ajrore dhe nentokesore	430,000	430,000	
15	Tarife per mbetjet inerte	15,000	15,000	
16	Tarifa për ndikimin ne mjedis			

		7,283,000	7,283,000	
17	Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.	120,000	120,000	
18	Kamatvonesa	1,000,000	1,000,000	
19	Detyrimi i prapambetur nga taksat	19,600,000	19,600,000	
	Shuma	67,200,000	67,200,000	
	Tarifa ne sektorin e pyjeve dhe kullotave			
1	Tarifa ne Sektorin e Pyjeve	28,000,000	22,000,000	(6,000,000)
2	Tarifa ne Sektorin e Kullotave	800,000	800,000	
3	Tarifa nga shfrytezimi i materialit drusor nga subjektet	18,900,000	10,000,000	(8,900,000)
4	Nga shfrytezimi I druve te zjarrit nga fshataresia	5,000,000	5,000,000	
5	Nga shfrytezimi I prodhimeve te dyta pyjore, te tjera .	300,000	300,000	
6	Te ardhura nga perdorimi vertetimeve te transportit kamate vonese dok. Ankandi rap teknik etj	500,000	500,000	
7	Te ardhura nga shitja e materialit drusor qe dalin nga rrallimet	200,000	200,000	
	Shuma	53,700,000	38,800,000	
	Te ardhura te tjera			
1	Qera e shitje trualli	-	-	
2	Qera ndertese , qera ndertese nga privatizimet	472,000	472,000	
3	Pagesa e prinderve çerdhe	2,400,000	2,400,000	
4	Pagesa e prinderve kopesht	9,200,000	9,200,000	
5	Detyr.te prapamb.nga kopshtet cerdhe dhe qendra ditore	1,424,000	1,424,000	
6	Gjoha nga IMT ,dhe Policia Bashkiake	1,650,000	1,650,000	
7	Te ardhura nga pullat e gjendjes civile 5 %	30,000	30,000	
8	Sponsorizime	-	3,083,000	3,083,000
	Shuma	15,176,000	18,259,000	

	TOTALI	220,385,000	214,268,000	(6,117,000)
--	---------------	--------------------	--------------------	--------------------

Pra sic shihet në mënyrë të përmblodhur janë paraqitur ndryshimet shtesë dhe pakësim plani në zërin si më poshtë tabelës :

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore		<i>Në /Lekë</i>		
Nr	Lloji i taksës e tarifës	Planifikimi Viti 2025 Ishte	Planifikimi Viti 2025 Bëhet	Shtesa dhe pakësime
	<i>Të ardhura tatimore dhe jo tatimore</i>			
1	Tarifa në Sektorin e Pyjeve	28,000,000	22,000,000	(6,000,000)
2	Tarifa nga shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet	18,900,000	10,000,000	(8,900,000)
3	Sponsorizime	-	3,083,000	3,083,000
4	Taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale	12,000,000	15,000,000	3,000,000
5	Taksa e regjistrimit përvitshëm të automjeteve	15,000,000	17,700,000	2,700,000
	SHUMA	73,900,000	67,783,000	(6,117,000)

- Sponsorizime
Ishte 0 lekë , bëhet 3,083,000 lekë
- Tarifa në Sektorin e Pyjeve
Ishte 28,000,000 lekë , bëhet 22,000,000 lekë .
- Tarifa nga shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet
Ishte 18,900,000 lekë , bëhet 10,000,000 lekë.
- Taksa nga tatimi mbi të ardhurat personale
Ishte 12 ,000,000 lekë, bëhet 15,000,000 lekë
- Taksa e regjistrimit përvitshëm të automjeteve
Ishte 15,000,000 lekë, bëhet 17,700,000 lekë .
Totali shtesë 8,783 ,000 lekë dhe ulje plani 14,900 ,000 lekë .
Buxheti total vjetor 2025
Ishte 220,385,000 lekë Bëhet 214,268,000 lekë .

Ndryshimet në planin e buxhetit 2025 janë referuar realizimit faktik për periudhën 10 mujore 2025 si :

Tatimi mbi të ardhurat personale , taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve që janë realizuar mbi 100 % të planit.

Gjithashtu është pasqyruar shtesë plani për zërin sponsorizime , zë i cili nuk është planifikuar në fillim të buxhetit.

Adresa : Sheshi "Gjorg Golemi"Librazhd, www.bashkialibrazhd.gov.al info@bashkialibrazhd.gov.al

Për sa i përket uljes së planit buxhetor 2025 në zërin :

- dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe
- shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet,

nga Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, është bërë për faktin se kërkesat nga subjektet për marrjen e fondit pyjor kullosor dhe për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtimit të paneleve fotovoltaike nuk u realizuan dhe nuk u lidhen kontrata .Me daljen e ligjit për paketën e maleve ,grupi i punës u mor me studimin e zonave prioritare për zhvillim për mos krijuar mbivendosje bashkia nuk zhvilloi ankande publike për dhënien në përdorim të fondit pyjor/ kullosor.(informacioni nga Sektori Menaxhimit Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave) .

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2025 janë të rëndësishme për një pasqyrim sa më korrekt të planifikimit drejt realizimit faktik të buxhetit vjetor dhe përmbushjen e funksioneve të Bashkise ndaj komunitetit.

Duke shpresuar në miratimin tuaj!

DREJTORE E TË ARDHURAVE VENDORE

Lindita Shuli



P/Vendim
N^o 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

PROJEKT - V E N D I M

NR ____ DATË ____ / ____ 2025

“PËR LINJAT KRYESORE DHE ORARET E TRANSPORTIT RRETHQYTETAS “

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për Vetë Qeverisjen Vendore“, Neni “ 19 “ i Ligjit Nr. 8308 , datë 18.03.1998 “ Për Transportet Rrugore “ i ndryshuar ,me Ligjin Nr.10/2016, pasi u shqytuan të gjitha linjat dhe oraret e linjave rrethqytetase dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë ____ / ____ /2025.

V E N D O S I:

Të miratojë :

- 1- Linjat kryesore dhe ushqyese ,oraret për transportin rrethqytetas .
- 2- Linjat kryesore dhe ushqyese rrethqytetase të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Librazhd sipas tabelës Nr. 1 dhe 2 (bashkëlidhur tabela Nr . 1 dhe 2)
- 3- Oraret e nisjes dhe të kthimit të linjave kryesore dhe ushqyese rrethqytetase të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Librazhd sipas tabelës Nr. 3 dhe 4 (bashkëlidhur tabela Nr .3 dhe 4).
- 4- Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore ,Policia Bashkiake si dhe njësitë administrative përkatëse .
- 5- Shfuqizimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.116, datë 28.12.2022, si dhe të gjitha vendimeve të mëparëshme të Këshillit të Bashkisë të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim.
- 6- Ky vendim hyn në fuqi më 1 Janar 2026 .

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha

Date 18.11.2025

BASHKIA LIBRAZHD

Tabela nr. 1

LINJAT KRYESORE RRETHQYTETESE

Nr	Linjat Kryesore			
NJESIA ADMINISTRATIVE HOTOLISHT				
1	A	Librazhd	Hotolisht	Librazhd
	B	Hotolisht	Librazhd	Hotolisht
2	A	Vehcan	Librazhd	Vehcan
	B	Librazhd	Vehcan	Librazhd
3	A	Xhyre	Librazhd	Xhyre
	B	Librazhd	Xhyre	Librazhd
4	A	Dardhe	Librazhd	Dardhe
	B	Librazhd	Dardhe	Librazhd
5	A	Hot. Fshat	Hotolisht	Hot. Fshat
	B	Hotolisht	Hot. Fshat	Hotolisht
6	A	Çerçan	Librazhd	Çerçan
	B	Librazhd	Çerçan	Librazhd
NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER				
7	A	Spathar	Librazhd	Spathar
	B	Librazhd	Spathar	Librazhd
8	A	Dragostunje	Librazhd	Dragostunje
	B	Librazhd	Dragostunje	Librazhd
9	A	Librazhd Katund	Librazhd	Librazhd Katund
	B	Librazhd	Librazhd Katund	Librazhd
10	A	Babje	Librazhd	Babje

10	B	Librazhd	Babje	Librazhd
11	A	Qarrishte	Librazhd	Qarrishte
	B	Librazhd	Qarrishte	Librazhd
12	A	Gizavesh	Librazhd	Gizavesh
	B	Librazhd	Gizavesh	Librazhd
13	A	Dorez	Librazhd	Dorez
	B	Librazhd	Dorez	Librazhd
14	A	Kuturman	Librazhd	Kuturman
	B	Librazhd	Kuterman	Librazhd
NJESIA ADMINISTRATIVE POLIS				
15	A	Polis Vilan	Librazhd	Polis Vilan
	B	Librazhd	Polis Vilan	Librazhd
16	A	Gurshpate	Librazhd	Gurshpate
	B	Librazhd	Gurshpate	Librazhd
17	A	Polis Gostime	Librazhd	Polis Gostime
	B	Librazhd	Polis Gostime	Librazhd
18	A	Polis Sheh	Librazhd	Polis Sheh
	B	Librazhd	Polis Sheh	Librazhd
19	A	Mirake	Librazhd	Mirake
	B	Librazhd	Mirake	Librazhd
NJESIA ADMINISTRATIVE ORENJE				
20	A	Rinas	Librazhd	Rinas
	B	Librazhd	Rinas	Librazhd
21	A	Gurakuq	Librazhd	Gurakuq

21	B	Librazhd	Gurakuq	Librazhd
22	A	Orenje Katund	Librazhd	Orenje Katund
	B	Librazhd	Orenje Katund	Librazhd
23	A	Orenje	Librazhd	Orenje
	B	Librazhd	Orenje	Librazhd
24	A	Zdrajsh Katund	Librazhd	Zdrajsh Katund
	B	Librazhd	Zdrajsh Katund	Librazhd
25	A	Zdrajsh	Librazhd	Zdrajsh
	B	Librazhd	Zdrajsh	Librazhd
26	A	Floq	Librazhd	Floq
	B	Librazhd	Floq	Librazhd
27	A	Funarez	Librazhd	Funarez
	B	Librazhd	Funarez	Librazhd
NJESIA ADMINISTRATIVE LUNIK				
28	A	Lunik	Librazhd	Lunik
	B	Librazhd	Lunik	Librazhd
29	A	Prevalle	Librazhd	Prevalle
	B	Librazhd	Prevalle	Librazhd
30	A	Kostenje	Librazhd	Kostenje
	B	Librazhd	Kostenje	Librazhd
31	A	Zgosht	Librazhd	Librazhd
	B	Librazhd	Zgosht	Librazhd
32	A	Letem	Librazhd	Letem

	B	Librazhd	Letem	Librazhd
NJESIA ADMINISTRATIVE STEBLEVE				
33	A	Stebleve	Librazhd	Stebleve
	B	Librazhd	Stebleve	Librazhd
34	A	Studen	Librazhd	Studen
	B	Librazhd	Studen	Librazhd
Linja të Specializuara:				
1	A	Polis Gurshpate	Polis Sheh	Polis Gurshpate
	B	Polis Sheh	Polis Gurshpate	Polis Sheh
2	A	Dragostunje	Librazhd	Dregostunje
	B	Librazhd	Dragostunje	Librazhd

Tabela nr. 2

LINJAT USHQYESE RRETH QYTETESE DHE ORARET E LEVIZJEVE TE TYRE

NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER				
1	A	Dragostunje	Mërqize	Dragostunje
	B	Mërqize	Dragostunje	Mërqize

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha

P

[illegible]



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Librazhd më, 18.11.2025

RELACION
“PËR LINJAT KRYESORE DHE ORARET E TRANSPORTIT RRETHQYTETAS ”

Të nderuar Këshilltarë!

Mbështetur në Ligjin Nr. 139, datë 17.02.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” i ndryshuar , Ligjin Nr. 8308 ,datë 18.03.1998 , “ Për Transportet Rrugore ” i ndryshuar , neni “ 19 ” , Rrjeti i linjave rrethqytetëse, stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 15,“miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe “ ç” miratohen nga Këshilli i Qarkut, ku thuhet se “ Rrjeti i linjave rrethqytetëse miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të çënojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse. Për këtë po paraqesim për miratim në Këshillin Bashkiak ,linjat dhe oraret e transportit rrethqytetas të udhëtarëve të përditësuar nga periudha 2022- deri 2025 sipas projekt vendimit .

Kërkojmë që të miratohen linjat dhe oraret sipas tabelës Nr. 1,2 dhe tabelës Nr. 3,4 të rrjetit të transportit rrethqytetas për funksionimin normal të tij , kjo në zbatim të nenit “ 19 ” të Ligjit Nr. 8308 ,datë 18.03.1998 .

Gjithashtu për të mos krijuar konflikt me subjektet dhe për të qënë në ndihmë të komunitetit në oraret që janë të domosdoshme për transportin e udhëtarëve .

Sa më lart kërkojmë që të miratohen linjat dhe oraret sipas pikave në Projekt- Vendim.

Ju faleminderit !

DREJTORE E TË ARDHURAVE VENDORE

Lindita Shuli

p/berolium
N°5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

PROJEKT-VENDIM

Nr ____ Datë ____ . ____ .2025

"PËR MIRATIMIN E NDËRHYRJEVE NË PRONË PUBLIKE PËE EFEKT TË MBROJTJES
SË PRONAVE PRIVATE"

Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, që përcakton kompetencat e Këshillit Bashkiak për administrimin e infrastrukturës publike dhe dhënien e autorizimeve për ndërhyrje në hapësira publike. Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015, për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, i ndryshuar. Kërkesës me shkrim të paraqitur nga z. Nazmi Dashi, pronar i pasurisë nr. 9/200, zk. 2446, në lagjen nr. 1, qyteti Librazhd. Kërkesës me shkrim të paraqitur nga z. Xhevat Hysa, pronar i pasurisë nr. 6/706, zk. 2446, në lagja e Shesë, qyteti Librazhd. Praktikës teknike dhe dokumentacionit të bashkëngjitur: projekti konstruktiv i hartuar nga inxhinier i licencuar, certifikata e pronësisë, harta treguese. Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date ____ . ____ .2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

TË VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së z. Nazmi Dashi, për realizimin e punimeve të **përforcimit të skarpatës së përroit të Shesë**, ngjitur me objektin e tij të shërbimit, me synim mbrojtjen e pronës nga erozioni dhe prurjet e larta të përroit.
2. Miratimin e kërkesës së z. Xhevat Hysa, për realizimin e punimeve të **ndërtimit të murit mbajtës në veri të banesës së tij**, me synim mbrojtjen e pronës nga rrëshqitjet e dherave.
3. Realizimi i punimeve do të kryhet **me shpenzimet e kërkuarit**, pa pretendim financiar ndaj Bashkisë Librazhd.
4. Punimet nuk duhet të cenojnë:
 - pronat publike,
 - pronat private kufitare,
 - gjurmën e përroit dhe funksionin hidroteknik të tij,Çdo devijim nga projekti i miratuar ndalohe.
5. Kontrolli dhe mbikëqyrja e zbatimit të këtij vendimi i ngarkohen:
 - Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
 - Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit.
 - Drejtoria e Shërbimeve Publike.
6. Ky Projekt-vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha

RELACION

PËR KËRKESAT E Z. NAZMI DASHI DHE Z. XHEVAT HYSA PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE NË FUNKSION TË MBROJTJES SË PRONËS

I. Objekti i relacionit

Ky relacion hartohet mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga:

1. Z. Nazmi Dashi, pronar i objektit të shërbimit me nr. pasurie 9/200, zk. 2446, në lagjen nr. 1, qyteti Librazhd.
2. Z. Xhevat Hysa, pronar i pasurisë nr. 6/706, zk. 2446, banor në lagjen nr. 1, qyteti Librazhd.

Të dy kërkuesit paraqesin nevojën e ndërhyrjeve konstruktive për mbrojtjen e pronave të tyre nga erozioni, rrëshqitjet e dherave dhe prurjet e larta të përroit të Shesë, gjatë periudhave me reshje intensive.

II. Gjendja ekzistuese dhe problematika

1. Rasti i z. Nazmi Dashi

Objekti i shërbimit i z. Dashi ndodhet ngjitur me përroin e Shesë, në një zonë ku prurjet e ujit gjatë shirave të rrëmbyeshëm shkaktojnë:

- Zhvendosje të materialeve në bazament të objektit;
- Rrezik dëmtimi të godinës për shkak të prites ekzistuese e cila nuk është ndërtuar sipas parametrave të duhur teknikë.

Situata paraqet rrezik të vazhdueshëm për stabilitetin e objektit të shërbimit.

2. Rasti i z. Xhevat Hysa

Banesa e z. Hysa ka këto problematika:

- Rrëshqitjes së dherave në pjesën veriore të pronës
- Erozionit të skarpates nga reshjet
- Rrezikut të cenimit të strukturës së banesës dhe sipërfaqes ndihmëse.

Ndërhyrja në këtë zonë është e domosdoshme për të shmangur degradimin e mëtejshëm të terrenit dhe për të garantuar sigurinë e pronës.

III. Propozimet për ndërhyrje

1. Kërkesa e z. Nazmi Dashi

Z. Dashi propozon:

- Përforcimin e skarpates së përroit me mur mbajtës betoni, sipas projektit të paraqitur.

- Punimet do të realizohen pa prekur pronat përreth dhe në përputhje me parametrat teknikë të përcaktuar.

Kjo ndërhyrje synon rritjen e sigurisë së objektit të shërbimit dhe stabilizimin e shtratit të përroit.

2. Kërkesa e z. Xhevat Hysa

Z. Hysa propozon:

- Ndërtimin e një muri mbajtës në pjesën veriore të banesës së tij;
- Stabilizimin e terrenit dhe shmangien e rrëshqitjeve të dherave;
- Punimet do të realizohen sipas projektit teknik të depozituar pranë njësisë përkatëse.

Ndërhyrja garanton mbrojtjen e banesës dhe minimizimin e rreziqeve nga reshjet e dendura.

IV. Përgjegjësia financiare

Të dy kërkuesit, z. Nazmi Dashi dhe z. Xhevat Hysa:

- Do të realizojnë punimet me shpenzimet e tyre;
- Deklarojnë se nuk kanë pretendime financiare ndaj Bashkisë Librazhd apo institucioneve të tjera;
- Do të përdorin subjekte të licencuara dhe do të respektojnë legjislacionin në fuqi për kontraktimin dhe zbatimin e punimeve ndërtimore.

V. Përfundime dhe rekomandime

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vlerësimit teknik paraprak:

- Punimet e kërkuara nga të dy kërkuesit janë të domosdoshme për mbrojtjen e pronave dhe për minimizimin e rreziqeve nga erozioni, prurjet e ujit dhe rrëshqitjet e dherave;
- Ndërhyrjet nuk cenojnë interesin publik dhe nuk prekin pronat e tjera;
- Të dy subjektet marrin përsipër përgjegjësinë e plotë financiare dhe ligjore.

Rekomandohet miratimi i kërkesës së z. Nazmi Dashi dhe z. Xhevat Hysa, për realizimin e punimeve të përforcimit dhe ndërtimit të mureve mbajtëse në zonat përkatëse, sipas projekteve teknike të paraqitura

Relatoi: Enri Gjura

Konfirmoi: Klodian Burgjia

Urbanistika

7195

DT 22.10.2025

22.10.25

Kerkese

Librazhd me ___/___/2025

Drejtuar: Zyres se Urbanistikes, Bashkia Librazhd

Kam nje objekt sherbimi me nr pasurie 9/200, ne lagjen nr.1, qyteti Librazhd ngjitur me perroin e shese, duke qene se gjate diteve me reshje shiu, perroi ka prurje te medha, me rrezikohet objekti prita ekzistuese nuk eshte ndertuar sipas parametrave te duhura.

Kerkoj nga ana juaj te realizoj perforcimin e skarpates se perroit, me mur betoni me shpenzimet e mia sipas projektit te hartuar pa cenuar prona te tjera.

Bashkelidhur kerkeses po ju ve ne dispozicion:

- projektin konstruktiv te te hartuar nga inxhinier i licensuar.
- Certifikata e prones
- Harte treguese

Jam ne pritje te pergjigjes tuaj!

Me respekt Nazmi Dashi.

Urbanistika
Emër-civile

7079

Dt 16.10.2025

~~Kërkesë:~~

Drejtuar : Bashkisë Librazhd

17.10.25

Drejtorisë Urbanistikës.


Unë I Nëshkruari Xhevat Selim Hysa banues në Librazhd në
Lagjen Nr 2 Sheja.

Kam shtëpinë tek lagja Sheja 3 katëshe pranë një shpati
kodre dhe here pas here krijohen shembje dheu dhe
gurëve më afrohet tek muri dhe dritaret. Kërkoj nga ana e
Bashkisë Librazhd dhe zyrës përkatëse të më jepet leje
për një mur mbajtës për mos renien e dherave se më
është bërë hall cdo vit që fillojnë shirat.

Mbetem me shpresë që kërkesa ime do aprovohet sa më
shpejt.

Me respekt Xhevat Hysa

Kontakt:0682570824





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHÐ
Sektori i Mbrojtjes Civile

PROCES - VERBAL
KONSTATIMI

I mbajtur sot me datë 01/08/2022 në lagjen Ura e Shesë, qyteti Librazhd, Bashkia Librazhd nga komisioni i Mbrojtjes Civile i ngritur me urdhër Nr. 618 datë 01/08/2022 të Kryetarit të Bashkisë Librazhd. "Për verifikimin dhe rikonstatimin e gjendjes të objektit shtëpi banimi të Z. Xhevat HYSA.

Komisioni pasi bëri verifikimin në vend të gjendjes së banesës të Z. Xhevat Hysa banorë i lagjes ura e Shesë, qyteti Librazhd, Bashkia Librazhd konstatoi se:

Objekti shtëpi banimi i shtetasit Xhevat Hysa është ndërtuar mbi sipërfaqe të pjerrët në lagjen Ura e Shesë. Në kohë me shirë dhe ujë shpesh e dihet nga sipërfaqja e vlerësuar dhe gjatë të shkurtyrës së banesës. Komisioni i M.C. i Bashkisë Librazhd dhe vlerësoi se pronari i banesës mund të ndërtojë një murë mbrojtës me gjatësi 19 m dhe lartësi 4 m për të parandaluar rrënimin dhe goditjen e fates së murit nga dhërra dhe gjatë sipërfaqes së shirave dhe erëzimit. Ndërtimi i një ose dy murave mbrojtës në anën e terraces mbi këtë objekt banimi do të bëhet me lehtësi dhe me shpejtësi dhe me superzimet e vetë pronarit të banesës. Njëkohësisht nga Komisioni pronarit të objektit iu kërkua që të mos krijojë konfliktet e mosmarrëveshjeve me banorët e tjerë të lagjes.

Shënim : Ky proces - verbal u mbajt në tre kopje dhe u firmos nga komisioni.

KOMISIONI

Anëtar
Mehmet BARDHOSHI

Kryetari
Rrapush BAHITI

Anëtar
Ervin QATJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE ME BASHKIMI
EUROPIAN

RELACION MBI RAPORTIN E PERFORMANCES

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit Bashki të Forta, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, Orgnizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Zvicrës SDC) dhe Qeverisë së Suedisë (Ambasada e Suedisë në Shqipëri) i zbatuar nga Helvetas. Projekti ka si synim kryesor që qytetarët shqiptarë të përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe i shërbimeve në nivel vendor sipas standardeve minimale dhe të përballueshme të miratuara për një sistem të qëndrueshëm në vend.

Raporti i Performancës 2024 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Bashkia Librazhd në vitin 2024 paraqet një situatë të ndërthurur mes stabilitetit në funksionet themelore dhe sfidave strukturore të lidhura me demografinë, territorin malor dhe shpërndarjen e popullsisë. Në tërësi, Librazhdi është një bashki me potencial të fortë natyror, infrastrukturë të përmirësuar dhe stabilitet financiar.

Raporti i Performancës për vitin 2024 është realizuar me të dhënat e vitit 2023-2024 duke u bërë një krahasim me rezultatet e nxjerra nga secila drejtori për secilin vit duke dalë në një përfundim dhe rekomandim. Të dhënat u mbledhën nga: Drejtoria e Funksioneve të Patransferueshme, Drejtoria e Burimeve Njerezore, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Mbrojtja Sociale, Drejtoria e Shërbimit Publik, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Integrimit dhe Projekteve me Bashkimin Europian. Për secilin drejtori në bazë të të dhënave duket se ka pasur rritje ose qëndrueshmëri.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE ME BASHKIMIN EUROPIAN

Alen KOPACI